

Attached is an advance copy of the **Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo** for the information of the members of the Security Council.

This report will be issued as a document of the Security Council under the symbol S/2018/981.

1 November 2018

## **Raport i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë**

### **I. Hyrje dhe prioritetet e Misionit**

1. Ky raport parashtrohet në pajtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit, përmes së cilës Këshilli themeloi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe kërkoi nga unë që të raportoj në intervale të rregullta kohore për zbatimin e mandatit të tij. Në këtë raport mbulohen aktivitetet e UNMIK-ut dhe zhvillimet lidhur me to, duke filluar nga data 16 korrik deri më 15 tetor 2018.
2. Prioritetet e Misionit mbesin avancimi i sigurisë, stabilitetit dhe i respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovë e regjion. Në arritjen e objektivave të tij, UNMIK-u vazhdon angazhimin konstruktiv me Prishtinën dhe Beogradin, me të gjitha komunitetet në Kosovë dhe me palët regjionale e ato ndërkombëtare. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Forca e Kosovës (KFOR) vazhdojnë së zbatuari të roleve të tyre brenda kornizës së Rezolutës 1244 (1999). Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) vazhdon praninë e tij në Kosovë në përputhje me deklaratën e kryetarit të Këshillit të Sigurimit, të datës 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44) dhe me raportin tim të datës 24 nëntor 2008 (S/2008/692). Agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara bashkëpunojnë ngushtë me Misionin.

### **II. Zhvillimet kryesore politike dhe të sigurisë**

3. Gjatë periudhës raportuese, kryetari i Serbisë, Aleksandar Vučić dhe kryetari i Kosovës, Hashim Thaçi, rihapen nocionin e përkufizimit territorial në kuadër të përpjekjeve të tyre të vazhdueshme në arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve. Në fjalimet e tyre të mbajtura në Forumin Ekonomik të Alpbahut në Austri më 25 gusht, të dytë theksuan nevojën për arritjen e një marrëveshjeje të tillë, e cila, siç thonë ata, mund të përfshinë përkufizimin territorial.
4. Në kontekstin e përkufizimit territorial, pas takimit me përfaqësuesit e regjionit jugor të Serbisë të luginës së Preshevës, të datës 26 korrik, dhe në deklaratat pasuese, kryetari Thaçi ftoi që “kërkesa legjitime e përfaqësuesve të luginës së Preshevës për t’iu bashkuar Kosovës” të diskutohet brenda kornizës së dialogut të përkrahur nga Bashkimi Evropian mes Beogradit dhe Prishtinës. Deklaratat e kryetarit në favor të “korrigjimit paqësor të kufirit” me Serbinë kanë nxitur kritika të përfaqësuesve të opozitës dhe të grupeve të shoqërisë civile, si dhe të anëtarëve të koalicionit qeverisës, duke përfshirë ato të kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, i cili gjatë periudhës raportuese ritheksoi kundërshtimin ndaj çfarëdo ndryshimi territorial.

5. Më 12 shtator, udhëheqësit e partive opozitare të Kosovës, pra të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Vetëvendosjes, Partisë Socialdemokrate të Kosovës dhe të Alternativës, ia dërguan një letër të përbashkët Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë, Federica Mogherini, ku shprehej mospajtimi me propozimin për “korrigjim kufiri” të bërë nga kryetarët Vuçiq dhe Thaçi, dhe tërhiqej vërejtja lidhur me ndikimin e mundshëm negativ të “korrigjimit të kufirit” për paqe dhe stabilitet në regjion. Më 29 shtator, Vetëvendosja organizoi një marsh protestues në Prishtinë kundër propozimit të kryetarit Thaçi për përfshirjen e “korrigjimit të kufirit” në çfarëdo marrëveshje përfundimtare me Beogradin, ku raportohet të kenë marrë pjesë rreth 20.000 persona.
6. Më 6 tetor, deputetët shqiptarë të koalicionit qeverisës u pajtuan për një propozimrezolutë, përmes së cilës përcaktohej pozita e Kosovës në dialogun me Beogradin të mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe përbërja e ekipit negociator të Kosovës. Në mes të tjerash, në këtë propozimrezolutë theksohet se dialogu mes Beogradit dhe Prishtinës duhet të rezultojë me një marrëveshje ligjërish obliguese, përmes së cilës do të mundësohej njohja e ndërsjellë në bazë të “kufijve të pacenueshëm dhe të panegociueshëm” të Kosovës. Lista Serbe dhe partitë opozitare nuk e përkrahën propozimrezolutën. Rrjedhimisht, përpjekjet e Kuvendit të Kosovës për krijimin e një ekipi negociator me bazë të gjerë që do ta përfaqësonte Kosovën në dialogun e mbështetur nga Bashkimi Evropian mbetën të papërmbyllura deri në fund të kësaj periudhe raportuese.
7. Deklaratat e udhëheqësve serbë të Kosovës lidhur me përkufizimin territorial shkaktuan shqetësim në radhët e komunitetit serb të Kosovës dhe mospajtime mes zyrtarëve të Beogradit dhe udhëheqësve të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë. Në deklaratat e ndara publike në fund të korrikut, peshkopi Teodosije i Rashkës-Prizrenit dhe abati i manastirit të Deçanit, ati Sava Janjiq, kritikuan planet e pretenduara për “ndarjen e Kosovës”. Megjithatë, më 12 gusht, Lista Serbe deklaroi se “përkufizimi me shqiptarët e Kosovës do të ishte i pranueshëm nëse do të garantonte të drejtat dhe liritë për serbët e Kosovës”. Në një letër të hapur, të dërguar më 15 gusht, kryetarët e dhjetë komunave me shumicë serbe dhe deputetët e Listës Serbe shprehën përkrahje për kryetarin Vuçiq në gjetjen e një zgjidhjeje kompromisi me Prishtinën.
8. Referencat e kryetarëve Vuçiq dhe Thaçi në përkufizimin territorial gjithashtu nxitën reagime në regjion dhe në komunitetin më të gjerë ndërkombëtarë, duke filluar nga thirrjet që palët të lihen për të shqyrtuar të gjitha mundësitë drejt një zgjidhjeje gjithëpërfshirëse e deri te shprehja e shqetësimeve serioze për pasojat që çfarëdo lloj përshtatjeje territoriale mund të ketë për stabilitetin e regjionit.

9. Në një zhvillim tjetër, më 13 shtator, kryeministri i Kosovës miratoi dhe ia dorëzoi për shqyrtim Kuvendit të Kosovës tri propozimligje për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri. Kryetari Thaçi, duke shprehur përkrahjen e tij për këtë nismë, ftoi për bashkërendim të ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare lidhur me këtë çështje. Megjithatë, autoritetet serbe dhe Lista Serbe shprehen kundërshti të fuqishme ndaj këtyre propozimligjeve, duke theksuar qëndrimin e tyre se një transformim i tillë do të ishte në kundërshtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit.
10. Gjatë periudhës raportuese, institucionet e Kosovës vazhduan të punojnë drejt arritjes së standardeve në fushat e tyre përkatëse, të caktuara nga Bashkimi Evropian. Më 18 korrik, komisioneri evropian për Migrim, Punë të Brendshme dhe Shtetësi, në një konferencë të përbashkët për media me kryetarin Thaçi në Bruksel, njoftoi se Kosova ka përmbushur të gjitha standardet e kërkuara për liberalizimin e vizave Shengen. Më 13 shtator, Parlamenti Evropian votoi për fillimin e negociatave me Këshillin e Bashkimit Evropian për liberalizimin e regjimit të vizave për Kosovën. Më 20 shtator, Kuvendi i Kosovës miratoi një pako të gjerë të ligjeve në përputhje me Instrumentin e asistencës së paraaderimit, të themeluar nga Bashkimi Evropian për Kosovë, ku përfshihet asistencë financiare në fushat e të drejtave të njeriut, eficiencës së energjisë dhe të ekonomisë.
11. Gjendja e sigurisë në Kosovë gjatë kësaj periudhe raportuese ka mbetur e qetë, edhe pse tensionet ndërkombëtare janë shpërfaqur në një numër incidentesh. Më 28 gusht, është anuluar për arsye sigurie një vizitë e planifikuar e serbëve të Gjakovës për shënimin e Ditës së Shën Marisë. Sipas Policisë së Kosovës, atë ditë rreth 70 shqiptarë u mbledhën para vendit të planifikuar të vizitës, Kishës së Virgjëreshës së Shenjtë, për të protestuar kundër vizitës. Me këtë rast pesë prej tyre u arrestuan për dëmtim prone dhe për pengim të Policisë së Kosovës në kryerje të detyrës.
12. Gjatë periudhës raportuese, kthimi i luftëtarëve të Kosovës nga zonat e konfliktit jashtë vendit vazhdon të mbetet çështje shqetësuese. Më 17 korrik, Gjykata themelore e Prishtinës dënoi shtatë individë për organizimin e grupeve terroriste dhe pjesëmarrjen në to, duke i dënuar me gjithsej 17 vjet e katër muaj burg. Më 31 korrik, Gjykata themelore e Prishtinës, dënoi një të akuzuar tjetër me dy vite burg për tentim të bashkimit me grup të huaj të armatosur. Më 5 tetor, Prokuroria Speciale e Kosovës ngriti padi kundër gjashtë individëve, duke përfshirë edhe një femër, lidhur me pretendimin për sulme terroriste në zonat me shumicë serbe dhe kundër trupave të KFOR-it. Të akuzuarit janë arrestuar në fund të qershorit pas një operacioni të përbashkët të policisë. Më 10 tetor, një person u dënua me një vit e gjysmë burg për shpërndarje në media sociale të materialeve ku mbështetej ISIS-i.

### III. Kosova e veriut

13. Më 16 korrik, gjashtë muaj pas vrasjes së politikanit serb të Kosovës, Olliver Ivanoviq, e cila mbeti e pazgjidhur, miqtë dhe familjarët morën pjesë në një ceremoni përkujtimore në vendin e vrasjes në Mitrovicë të Veriut. Më datën 30 gusht, kuvendi komunal i Mitrovicës së Veriut miratoi vendimin për rrimërimin e rrugës sipas z. Ivanoviq.
14. Më 8 gusht, drejtori i zyrës së Qeverisë së Serbisë për Kosovë e Metohi, Marko Gjuriq, dhe sekretari i përgjithshëm i Presidencës së Republikës së Serbisë, Nikolla Sellakoviq, vizituan Kosovën veriore, ku u takuan me përfaqësuesit e komunitetit serb të Kosovës.
15. Më 8 dhe 9 shtator, kryetari Vuçiq vizitoi katër komunat veriore të Kosovës. Ai iu drejtua një tubimi publik në Mitrovicë të Veriut, u takua me përfaqësuesit e komunitetit, si dhe vizitoi liqenin e Gazivodës dhe hidrocentralin. Vizita e planifikuar në fshatin Banjë të komunës së Skenderajt u desh të anulohet për shkak të protestave dhe bllokadave në rrugë të organizuara nga Shoqata e Veteranëve të Luftës e Kosovës. KFOR-i ka qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes. Kryetari Vuçiq gjithashtu vuri kurora lulesh në vendin e vrasjes së Olliver Ivanoviqit.
16. Më 29 shtator, kryetari Thaçi gjithashtu bëri një vizitë të shkurtër dhe të paparalajmëruar në liqenin e Gazivodës me përcjellje të Policisë së Kosovës, duke përfshirë edhe njësitë speciale, gjë që nxiti reagime të fuqishme si nga serbët e Kosovës, ashtu edhe nga zyrtarët e Beogradit. KFOR-i ka qenë i pranishëm në vendin e vizitës, duke përcjellë situatën nga afër. Pas shkuarjes së kryetarit Thaçi rreth 250 serbë lokalë, ku kishte udhëheqës dhe qytetarë, u mblodhën në liqenin e Gazivodës për të protestuar kundër vizitës dhe pranisë së njësiteve speciale të Policisë së Kosovës. Në deklaratën televizive të bërë të njëjtën ditë, kryetari Vuçiq tha se vizita e Thaçit ishte “sulm” i “paramilitarëve” të Prishtinës në veri, shkelje e dispozitave të marrëveshjes së Brukselit lidhur me lirinë e lëvizjes, si dhe e Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit. Njësitë ushtarake dhe policore të Serbisë raportohet se u ngritën në nivel më të lartë të gatishmërisë si reagim ndaj kësaj vizite.
17. Më 10 tetor, serbët e Kosovës mbajtën një mbledhim për të shënuar 2000 ditë nga data 19 prill 2013 e “Marrëveshjes së parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve” mes Beogradit dhe Prishtinës, ku në mes të tjerash parashihet themelimi i asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe. Në këtë mbledhim morën pjesë mbi 1500 persona, duke përfshirë zyrtarët komunalë nga veriu i Kosovës, anëtarët serbë të Qeverisë së Kosovës dhe përfaqësuesit e Qeverisë së Serbisë.

#### **IV. Normalizimi i marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës**

18. Më 18 korrik, Përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë ishte nikoqire në Bruksel e takimit të nivelit të lartë të dialogut të mbështetur nga Bashkimi Evropian mes Beogradit dhe Prishtinës. Në bazë të komunikatës së lëshuar pas takimit nga Shërbimi Evropian për Punë të Jashtme, kryetarët Vuçiq dhe Thaçi “shqyrtuan përparimin e bërë në diskutimet për kornizën e marrëveshjeve obliguese ligjore për normalizimin gjithëpërfshirës të marrëdhënieve mes dy palëve”. Pas takimit, kryetari Thaçi deklaroi se “ky ishte takimi më i shkurtër dhe më i vështirë në gjashtë vitet e fundit”. Kryetari Vuçiq shprehu zhgënjimin për atë që ai e përshkroi si “qëndrim i pakompromis i Prishtinës”, por vuri në pah se ka pajtim lidhur me vazhdimin e bisedimeve për “gjetjen e emëruesit të përbashkët të zgjidhjes së kompromisit”.
19. Më 4 gusht, ekipi menaxhues përgjegjës për hartimin e statutit të asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe shpalli përfundimin e punës së vet sipas afatit të caktuar nga Prishtina. Ekipi gjithashtu shfaqti gatishmërinë e tij që këtë propozimdokument t’ua dërgoj të dyja palëve në takimin e nivelit teknik në Bruksel, i cili nuk u organizua gjatë kësaj periudhe raportuese. Gjatë procesit të hartimit, Beogradi dhe Prishtina vazhduan me qëndrimet e tyre kundërshtuese lidhur me kompetencat e asociacionit/bashkësisë. Më 13 gusht, kryenegociatori i Prishtinës në dialogun e nivelit teknik me Beogradin shprehu pakënaqësinë me mungesën e informatave nga ekipi menaxhues lidhur me përmbajtjen e propozimstatutit dhe paralajmëroi se Prishtina mund ta refuzoj këtë propozimdokument nëse konstaton se nuk është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës.
20. Më 7 shtator, kryetari Vuçiq dhe kryetari Thaçi u takuan ndaras në Bruksel me Përfaqësuesen e lartë të Bashkimit Evropian, por refuzuan që të takohen sy me sy. Në deklaratën e saj dhënë mediave pas takimit, Përfaqësuesja e lartë shprehu bindjen në përkushtimin e palëve “për të arritur gjatë muajve vijues një marrëveshje ligjërish obliguese në përputhje me të drejtën ndërkombëtare”. Kryetari Vuçiq dhe kryetari Thaçi gjithashtu deklaruan se do të vazhdojnë të takohen ndaras me Përfaqësuesen e lartë derisa të mund të organizohet takimi i përbashkët. Më herët gjatë së njëjtës ditë, autoritetet e Kosovës kishin revokuar autorizimin e tyre për kryetarin Vuçiq lidhur me shkuarjen në liqenin e Gazivodës gjatë vizitës së tij të planifikuar më datat 8-9 shtator. Zyrtarët serbë protestuan kundër këtij vendimi, dhe më pas Qeveria e Kosovës deklaroi se vizita mund të organizohet sipas planit.

## V. Kthimet, pajtimi, trashëgimia kulturore dhe marrëdhëniet e komunitetit

21. Gjatë periudhës raportuese, Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) regjistroi 53 kthime vullnetare në Kosovë të anëtarëve të komuniteteve joshumicë (29 serbë, 16 egjiptas, katër malazez dhe katër boshnjakë). Me këta të kthyer gjithsej numri i të kthyerve vullnetarë në Kosovë nga radhët e komuniteteve joshumicë që nga viti 2000 shkoi në 27,937 (13,707 gra dhe 14,230 meshkuj). Sfidat lidhur me kthimin e pronave, ndarjen e tokës për ndërtimin e shtëpive, sigurinë dhe me mundësitë socio-ekonomike për të kthyerit vazhduan të ndikojnë negativisht në perspektivën për kthime të qëndrueshme.
22. Gjatë periudhës raportuese ka pasur tensione të ripërtërira mes Kishës Ortodokse Serbe dhe Qeverisë së Kosovës për shkak të punëve të ndërtimit të rrugës që çon në zonën e veçantë të mbrojtur të manastirit të Deçanit. Më 26 korrik, përfaqësuesit dhe udhëheqësit e Misionit në Kosovë vizituan zonën e veçantë të mbrojtur të manastirit të Deçanit së bashku me ministrin e Infrastrukturës të Kosovës. Në deklaratën e lëshuar pas vizitës, përfaqësuesit e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian theksuan se para çfarëdo aktiviteti që prek zonën e veçantë të mbrojtur duhet të konsultohet Këshilli për zbatim dhe monitorim dhe se vendimet e tij duhet të respektohen në plotëni. Këshilli për zbatim dhe monitorim nuk u takua gjatë periudhës raportuese.
23. Më 17 gusht, Kisha Ortodokse Serbe ia dërgoi një letër komunës së Lipjanit, përmes së cilës kundërshtojë ndërtimi i një objekti komercial dhe banesor brenda zonës së veçantë të mbrojtur të Kishës ortodokse serbe të Shpalljes së Virgjëreshës në qytetin e Lipjanit. Eparkia e Rashkës-Prizrenit kërkoi nga Departamenti i komunës për planifikim, urbanizëm dhe mjedis që këtë çështje t'ia sjell në vëmendje të Këshillit për zbatim dhe monitorim. Më 24 shtator, 250 serbë të Kosovës ia parashtruan një peticion kryetarit të komunës së Lipjanit kundër planeve të administratës komunale për ndërtimin e një qendre administrative të Bashkësisë Islame brenda së njëjtës zonë të veçantë të mbrojtur.
24. Pas vendimit të Ministrisë së Kosovës për Punë të Brendshme, të miratuar më 5 korrik, për regjistrimin civil të komuniteteve joshumicë në Kosovë, zyrat e regjistrimit civil në komunat Shtërpçë dhe Graçanicë filluan me transkribimin e dokumenteve të regjistrimit civil, të lëshuara nga institucionet e spozoruara prej Beogradit nga data 10 qershor 1999 deri më 14 shtator 2016, duke ua mundësuar kështu qytetarëve të prekur marrjen e dokumentacionit të Kosovës.
25. Gjatë periudhës raportuese, UNMIK-u vazhdoi me monitorimin e zhvillimeve lidhur me të drejtat e komuniteteve romë, ashkalike dhe egjiptase në Kosovë. Më 7 shtator, Ministria e Kosovës për Arsim, Shkencë e Teknologji, me përkrahje të Bashkimit Evropian, shpalli

dhënien e 500 bursave për 500 nxënës të shkollave të mesme nga radhët e komuniteteve rome, ashkalike dhe egjiptase për vitin aktual shkollor. Fondi i mirëbesimit për mbështetje të komuniteteve rome, ashkalike dhe egjiptase të prekura nga helmimi me plumb në Kosovë, i themeluar në vitin 2017 pas rekomandimeve të Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut të UNMIK-ut, mbeti i pafinancuar.

## **VI. Sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut**

26. Më 16 korrik, Gjykata e Apelit e Kosovës vërtetoi akuzën kundër ish-pjesëtarit të forcave rezerve të njësisë policore ose paramilitare jugosllave lidhur me pretendimin për kryerjen e krimeve të luftës në fshatin Krushë e Vogël mes datave 15 dhe 26 mars 1999. Më 7 gusht, Zyra e Prokurorisë Speciale e Kosovës ngriti aktakuzë para gjykatës themelore në Pejë kundër ish-policit serb lidhur me pretendimin për kryerjen e krimeve të luftës kundër popullatës civile në komunën e Klinës gjatë qershorit dhe korrikut të vitit 1998.
27. Më 23 korrik, gjykata themelore e Prishtinës liroi nga akuza ministrin e Kosovës për Zhvillim Ekonomik lidhur me pretendimet se në cilësinë e zyrtarit publik në vitin 2014 ai ia kishte drejtuar fondet një organizate joqeveritare që e kishte themeluar vet. Më 25 korrik, gjykata themelore e Gjakovës konfirmoi akuzën kundër ministrit të Kosovës për Infrastrukturë, ku pretendohet keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me shpërndarjen subvencioneve ilegale në cilësinë e tij si kryetar komune, por hodhi poshtë akuzën penale të “keqshpërndarjes së fondeve gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare”. Ministri vazhdoi të mbajë postin e vet përderisa është në pritje të gjykimit. Sigurimi që zyrtarët publikë të mbajnë përgjegjësi për keqpërdorimet e pretenduara të pushtetit është demonstrim i rëndësishëm i përkushtimit të institucioneve të Kosovës për qeverisje të mirë. Gjykimet e drejta dhe të paanshme të rasteve të tilla rrisin besimin e qytetarëve në institucionet e Kosovës.
28. Më 13 gusht, prokurori special, Elez Blakaj, dha dorëheqje për shkak të ndërhyrjeve të pretenduara politike dhe kërcënimeve lidhur me hetimin e disa rasteve të profilit të lartë, duke përfshirë edhe rastin e mashtrimeve të dyshuara për pensionet e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo dorëheqje nxiti protesta publike në Prishtinë, më datat 22 gusht dhe 26 shtator, ku kërkohet dorëheqja e kryeprokurorit dhe rishikimi i listës aktuale të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në dispozicion të Qeverisë së Kosovës. Më 14 shtator Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës ngriti padi para gjykatës themelore në Prishtinë kundër 12 ish-anëtarëve të Komisionit qeveritar përgjegjës për verifikimin e statusit të veteranit. Ata akuzohen për keqpërdorim të detyrës zyrtare përmes lëshimit ilegal të pensioneve, gjë që ka rezultuar me humbje prej përafërsisht 68 milionë euro. Përveç kësaj, në fund të shtatorit, gjykata themelore në Prishtinë lëshoi urdhra të ndara për mbajtje nën hetime për dy deputetë të Kuvendit të Kosovës lidhur me kërcënimet publike të anëtarëve të gjyqësorit.



29. Komisioni i Qeverisë së Kosovës përgjegjës për verifikimin dhe njohjen e statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale nga konflikti pranoi 179 aplikacione gjatë kësaj periudhe raportuese, 27 prej të cilave kanë fituar statusin e të mbijetuarit, 49 janë refuzuar dhe për 103 aplikacione ende pritet verifikimi. Gjithsej numri i aplikacioneve nga shkurti i vitit 2018, kur Qeveria e Kosovës zyrtarisht e hapi procesin e aplikimit, është 782, ku statusin e të mbijetuarit e kanë fituar 137 femra dhe gjashtë meshkuj, ndërsa 103 aplikacione janë refuzuar. Çështja e zhdëmtimit të të mbijetuarve të dhunës seksuale nga konflikti është diskutuar në punëtorinë e organizuar më 15 tetor 2015 në Prishtinë nga Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave (UN-Women), me përkrahje të Bashkimit Evropian.
30. Me kërkesë të Grupit të përbashkët punues për personat e zhdukur në lidhje me ngjarjet në Kosovë, UNMIK-u ndihmoi dhënie të një radari për skanime nëntokësore nga Qendra Globale për Shërbime të Kombeve të Bashkuara në Brindizi. Puna me këtë radar është bërë gjatë muajit gusht në lokacionet e propozuara nga Grupi i përbashkët punues në vazhden e përpjekjeve të vazhdueshme për identifikimin e lokacioneve të mundshme të vendvarrimeve.

## **VII. Gratë, paqja dhe siguria**

31. Në fillim të gushtit çështja e dhunës familjare në Kosovë tërhoqi vëmendje të shtuar të publikut pas vrasjes së pretenduar të një gruaje dhe vajzës së saj nga ish-bashkëshorti në Gjakovë. Grupet e shoqërisë civile organizuan demonstrata në Gjakovë dhe Prishtinë. Më 24 gusht, Grupi për siguri dhe çështje gjinore, grup ky shumëpalësh me interes i udhëhequr nga UN-Women dhe i përbërë nga përfaqësues ndërkombëtarë, qeveritarë dhe të shoqërisë civile, lëshoi një deklaratë ku kërkohet reagim më i fuqishëm institucional në parandalimin e dhunës kundër gruas. Sipas UN-Women, shkalla e vërtetë e problemit vazhdon të maskohet përmes numrit të vogël të rasteve të raportuara për shkak të perceptimit se dhuna në familje është çështje private, ku kësaj i shtohet edhe stigmatizimi nga shoqëria, frika nga hakmarrja, mungesa e besimit tek autoritetet kompetente dhe varësia ekonomike nga kryerësi i krimit.
32. Gjatë periudhës raportuese, anëtarët e Grupit për çështje gjinore dhe siguri përkrahen hartimin e amendamenteve në Kodin Penal të Kosovës me qëllim të përfshirjes së një përkufizimi më gjithëpërfshirës të dhunës në familje, si dhe në Ligjin për familjen për të përfshirë dispozitat lidhur me ndarjen e barabartë të pronave të përbashkëta. Këto amendamente i ka miratuar Kuvendi i Kosovës në leximin e parë më datën 23 korrik. Më 10 gusht, kryetarët e komunave Skenderaj, Vushtri dhe Mitrovicë e Jugut nënshkruan një memorandum mirëkuptimi, ku zotohen për mbështetje në përmirësimin e kushteve fizike dhe të jetesës në strehimoren regjionale për viktimat e dhunës në familje në Mitrovicë të Jugut.

33. Gjatë periudhës raportuese, më 5 shtator është ndërmarrë edhe një hap i mëtejshëm në avancimin e rolit të gruas në institucionet gjyqësore përmes themelimit të Asociacionit të Grave në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ky Asociacion ka për qëllim avancimin e udhëheqëseve femra në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe përmirësimin e efektshmërisë së institucioneve korrektuese të Kosovës.
34. Brenda kornizës së zbatimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit, më 15 shtator, UN-Women, me përkrahje të UNMIK-ut, organizuan një dialog me Lobin e Grave Regjionale për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore dhe me deputetë të parlamenteve të regjionit. Kjo ngjarje ua ofroi një platformë grave lidere në politikë dhe shoqëri civile për të diskutuar mënyrat e fuqizimit të grave me qëllim të avancimit të paqes dhe sigurisë, duke përfshirë edhe përmes ndikimit pozitiv në proceset aktuale politike.

### **VIII. Partneriteti dhe bashkëpunimi**

35. Gjatë periudhës raportuese, UNMIK-u në bashkëpunim të ngushtë me Ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, filluan ciklin e ri të aktiviteteve programatike në fushën e ndërtimit të besimit mes komuniteteve, të sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut. Partnerët e Kombeve të Bashkuara në Kosovë së bashku vazhduan me aktivitetet në mbështetje të zbatimit të ligjit, të shërbimit korrektues dhe të institucioneve gjyqësore, me fokus në qasje të barabartë në drejtësi, integrim të gjyqësorit, luftim të dhunës në familje dhe fuqizim të mekanizmave për ndihmë juridike.
36. Pas Forumit të Kombeve të Bashkuara për Ndërtimin e Besimit, të mbajtur në Lubjanë prej 6 deri më 8 maj, UNMIK-u, në partneritet me Ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, dha udhëzime dhe përkrahje strategjike për realizimin e nismave të identifikuara nga pjesëmarrësit e Forumit. Në korrik, UNMIK-u organizoi gjashtë punëtori pasuese me qëllim të orientimit të planeve të ardhshme të veprimit në secilën nga fushat tematike të trajtuara në Forum. Përkrahja për planet e veprimit është integruar në aktivitetet e planifikuara programatike të Misionit dhe është bashkërenduar me partnerët ndërkombëtarë, duke përfshirë Këshillin e Evropës, Bashkimin Evropian, EULEX-in dhe Misionin e OSBE-së në Kosovë. Raporti i Forumit është publikuar në shtator dhe i është prezantuar kryeministrit të Kosovës nga Përfaqësuesi Special. Kryeministri me këtë rast u zotua se do të ofroj bashkëpunimin dhe përkrahjen e Qeverisë për zbatimin e rekomandimeve të Forumit.
37. Prej datës 3 deri më 6 gusht, UNMIK-u organizoi trajnimin për anëtarët e Grupit Veprues të Rinisë së Kosovës (*Kosovo Youth Task Force*), me fokus në mënyrat se si t'i tërhiqet vëmendja pushtetit lokal, këshillave veprues të rinisë, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe udhëheqësve fetarë të komuniteteve për çështje të ndryshme. Më 11 gusht, me ftesë të kryeartit të komunës së Kamenicës dhe me përkrahje të UNMIK-ut, 120 të rinj nga

komunitetet e ndryshme dhe përfaqësues të pushtetit lokal në Kamenicë morën pjesë në konsultime të hapura për shënimin e Ditën Ndërkombëtare të Rinisë.

38. Më 9 gusht, UNMIK-u, në partneritet me Ekipin e Kombeve të Bashkuara për Kosovë, paraqiti një dokumentar për lidhjet në mes të dhunës në familje dhe interpretimeve tradicionale të të drejtave pronësore në festivalin e filmit në Prizren. Shfaqja u pasua me një diskutim në panel, të drejtuar nga drejtuesja e Zyrës UN-Women në Kosovë, duke përfshirë zëvendësministren e drejtësisë të Kosovës, një aktiviste për çështje ligjore dhe njëra nga të mbijetuarat e paraqitura në film.
39. Gjatë periudhës raportuese, UNMIK-u vazhdoi me ofrimin e shërbimeve të verifikimit të dokumenteve, duke shqyrtuar 634 dokumente, ku 367 lidhen me pensione dhe 267 me gjendjen civile, siç janë diplomatat e shkollës së mesme dhe ato universitare, si dhe certifikatat e martesave, të lindjeve dhe të vdekjeve. UNMIK-u po ashtu vazhdoi me lehtësimin e komunikimit ndërmjet autoriteteve të Kosovës dhe Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Penale (INTERPOL). UNMIK-u ka pranuar dhe shqyrtuar gjashtë kërkesa për lëshimin e letërreshtimeve ndërkombëtare.

## **IX. Vrojtimet**

40. E mirëpres angazhimin e vazhduar të Beogradit dhe Prishtinës në dialogun e përkrahur nga Bashkimi Evropian për normalizimin e marrëdhënieve. Duke i ditur sfidat me të cilat përballen liderët në secilën anë në kërkim të një zgjidhjeje, unë vazhdoj të jem i inkurajuar nga vendosmëria dhe përkushtimi i tyre në zgjidhjen e çështjeve të mbetura përmes dialogut dhe nxitjes së një përfshirjeje më të madhe të të gjitha segmenteve të shoqërisë në të dyja anët në këtë proces.
41. Perspektiva evropiane vazhdon të jetë thelbësore për konsolidimin e paqes dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor dhe për popullin e tij që të realizojë aspiratat e tyre. Në këtë drejtim, dua të falënderoj përkrahjen e vazhdueshme dhe angazhimin e Bashkimit Evropian, duke përfshirë edhe përmes strategjisë së Komisionit Evropian për Ballkanin Perëndimor, dhe përkrahjes së normalizimit të marrëdhënieve në mes të Beogradit dhe Prishtinës.
42. E mirëpres punën e drejtuar nga UNMIK-u, me mbështetjen e Ekipit të Kombeve të Bashkuara për Kosovën, për implementimin e rekomandimeve të rëndësishme që u arritën në Forumin e Kombeve të Bashkuara për Ndërtimin e Besimit, të mbajtur në Lubjanë më 6-8 maj. Në këtë drejtim, unë inkurajoj angazhimin e vazhdueshëm me Qeverinë e Kosovës, me shoqërinë civile dhe me partnerët bilateralë e ndërkombëtarë, për të siguruar mbështetjen e tyre aktive në përpjekjet për ndërtimin e besimit mes komuniteteve në Kosovë. Njëkohësisht, UNMIK-u, në bashkëpunim të ngushtë me Ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe me partnerët ndërkombëtarë duhet të vazhdojnë me kontributin

e tyre për pajtim shoqëror që është thelbësor për stabilitetin në Kosovë, si dhe me krijimin e kushteve të favorshme për kompromis. Fuqizimi i grave, i rinisë dhe i shoqërisë civile do të mbesin në qendër të përpjekjeve të këtij Misioni.

43. Jam i shqetësuar nga tensionet e përsëritura lidhur me aktivitetet ndërtimore në zonat e veçanta të mbrojtura. Rrjedhimisht, ju bëj thirrje të gjitha palëve në fjalë që të vazhdojnë përkushtimin e tyre në mbrojtje të trashëgimisë fetare, dhe po ashtu dëshiroj të ritheksoj rëndësinë e trajtimit të çështjeve të tilla në harmoni me legjislacionin e Kosovës dhe me vendimet e Këshillit për monitorim dhe zbatim.
44. Dhuna në familje mbetet një shqetësim serioz në Kosovë. Trajtimi i shkaqeve kryesore dhe sigurimi i zbatimit efektiv të legjislacionit relevant, kërkon vëmendje të qëndrueshme dhe përkushtim të mirëfilltë të të gjitha palëve institucionale. Së këndejmi, dëshiroj t'i inkurajoj të gjitha institucionet e Kosovës të ndërmarrin nisma të tjera për trajtimin e dhunës në familje, duke përfshirë fuqizimin e legjislacionit ekzistues dhe rritjen e përkrahjes për rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave të dhunës në familje, të drejtat e të cilave janë shkelur.
45. Theksoj me keqardhje mungesën e reagimit ndaj thirrjeve të Kombeve të Bashkuara për të kontribuar në fondin e mirëbesimit, të themeluar për mbështetjen e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, të prekur nga helmimi me plumb në Kosovë. Kontributet në fondin e mirëbesimit do të ishin një demonstrim i qartë i përkrahjes ndërkombëtare për këto komunitete të rrezikuara dhe për nevojat e tyre urgjente.
46. Unë e falënderoj Përfaqësuesin tim Special, Zahir Tanin, dhe gjithë punonjësit e UNMIK-ut për energjinë, për kreativitetin dhe për dedikimin e tyre që ia kanë kushtuar punës së Misionit. Falënderoj edhe njëherë partnerët e kamotshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, KFOR-in, OSBE-në, Përfaqësuesin e Bashkimit Evropian dhe zyrat në terren, si dhe agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara, për punën e tyre të vazhdueshme ekipore dhe për bashkëpunimin me UNMIK-un.

## Shtojca I

### **Raporti i Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm mbi aktivitetet e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, nga 16 korriku deri më 15 tetor 2018**

#### **1. Përmbledhje**

Pas fillimit të mandatit të tij të ri dyvjeçar në mes të qershorit 2018, EULEX-i vazhdoi me rekonfigurimin e tij, që do të zgjasë gjashtë muaj dhe parashihet të përfundojë në mes të dhjetorit. Ky Mision është në proces të rekrutimit të stafit ndërkombëtarë dhe vendorë sipas strukturës së re, dhe synon të arrijë kapacitete të plota operationale kah mesi i dhjetorit.

Një punë kryesore që ka të bëjë me rekonfigurimin përfshin finalizimin e procesit të dorëzimit të mijëra dosjeve të lëndëve të prokurorisë dhe policisë autoriteteve vendore, që lidhen me krimin e organizuar dhe me krimet e luftës.

Në të njëjtën kohë, EULEX-i, në bashkërendim me Përfaqësuesin Special të BE-së/Zyra e BE-së në Kosovë – ka përgatitur terrenin për një kalim të lehtë të disa funksioneve të tij monitoruese Përfaqësuesit Special të BE-së/Zyrës së BE-së në Kosovë. Meqë ky i fundit vazhdimisht rekruton dhe pozicionon ekspertë për të ndihmuar Policinë e Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe atë Prokurorial dhe Zyrën e gjendjes civile, EULEX-i do të mbështesë këtë proces duke i informuar në detaje kolegët e tij për gjendjen në vend dhe për sfidat e së ardhmes në secilin prej këtyre institucioneve për sundimin e ligjit.

Procesi i rekonfigurimit të EULEX-ut përkon me rritjen e vazhdueshme të përgjegjësive në sundimin e ligjit të institucioneve të Kosovës. Një shembull i mirë i kësaj është “Drejtësia 2020”, një iniciativë e drejtuar nga ministri i Drejtësisë, në bashkëpunim me kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial, e përkrahur nga Përfaqësuesi Special i BE-së/Zyra e BE-së në Kosovë, EULEX-i si dhe nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara dhe ajo e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, për të avancuar punën dhe përgjegjësinë e sistemit të drejtësisë në Kosovë. EULEX-

i, sipas mandatit të tij të ri të ristrukturuar, do ta mbështesë këtë iniciativë në pronësi vendore duke ofruar kapacitetet e veta monitoruese në sistemin e drejtësisë.

## **2.        **AKTIVITETET E EULEX-it****

### **2.1.      **Monitorimi****

EULEX-i ka vazhduar me monitorimin e lëndëve dhe gjykimeve të caktuara në sistemin gjyqësor të Kosovës, duke përfshirë në mes të tjerash disa nga lëndët e bartura të EULEX-it. Lëndët e caktuara, që u janë dorëzuar gjykatave vendore, janë monitoruar për së afërmi dhe janë vlerësuar nëse janë në harmoni me ligjet e Kosovës dhe me standardet e të drejtave të njeriut, në mesin e kriterëve të tjera ligjore. Sa i përket trajtimit të lëndëve të ndjeshme ose të profilit të lartë, EULEX-i ka identifikuar një tendencë shqetësuese të përfundimit apo ndryshimit të procedurave në interes të të pandehurve pa arsyetim të mjaftueshëm apo bazë ligjore, pasi EULEX-i përfundoi funksionet e tij hetimore, të ndjekjes penale dhe ato gjyqësore në mes të qershorit të vitit 2018. Për shembull, tash së fundi gjykata ka liruar nga arresti shtëpiak një të pandehur të profilit të lartë me arsyetimin se prokuroria nuk kishte kërkuar vazhdimin e mbajtjes. Mirëpo, sipas nenit 193 të Kodit të Procedurës Penale, është gjykata ajo që duhet të vlerësojë, sipas detyrës zyrtare, nëse arsyet për mbajtje ende ekzistojnë.

Sa i përket Shërbimit Korrektues të Kosovës, është përfunduar procesi i zgjedhjes së drejtuesve, udhëheqësve të lartë dhe shefave të njësive, me vetëm disa kandidatë të zgjedhur që presin miratimin përfundimtar nga drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës. Ky është një zhvillim pozitiv meqë disa pjesëtarë të stafit kishin mbajtur funksione të ushtruesit të detyrës për një kohë të gjatë, duke ndikuar shumë në efikasitetin e Shërbimit Korrektues të Kosovës. Për më tepër, Shërbimi Korrektues i Kosovës së shpejti do të shpallë konkurs për 120 vende të reja për zyrtarë korrektues.

Trajtimi i privilegjuar i një grupi të zgjedhur të të burgosurve të profilit të lartë mbetet shqetësim. Gjatë hospitalizimit të disa të burgosurve të profilit të lartë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, EULEX-i sërish ka vërejtur moszbatimin e rregulloreve nga zyrtarë të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Duke reaguar ndaj kësaj, EULEX-i i ka dhënë udhëheqësisë së lartë të Shërbimit Korrektues disa rekomandime. Këto përfshijnë ndryshimin e rregullores aktuale për mbrojtjen spitalore, për të cilën u pajtuam që të fillonte si një punë e përbashkët në shtator, ofrimin e një trajnimit të planifikuar në mënyrë specifike dhe rinisjen e mekanizmit përkatës të Shërbimit Korrektues të Kosovës për mbikëqyrje të

brendshme. Një repart i siguruar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës gjithashtu do të ndihmonte në zvogëlimin e rrezikut për trajtim të privilegjuar, për arratisje dhe për vizita të paautorizuara. Mirëpo, hapësira e caktuar për repart të sigurt aktualisht nuk është në përdorim.

Kohëve të fundit ka pasur disa incidente të rënda në Qendrën Korrektuese në Dubravë, duke përfshirë edhe vetëvrasjen e një të burgosuri në repartin psikiatrik, gjë që ka ngritur shqetësime për trajtimin mjekësor dhe për vetë incidentin, si dhe një arratisje nga dy të burgosur, duke treguar neglizhencën e stafit përgjegjës të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Muajt e fundit, Shërbimi Korrektues i Kosovës ka transferuar 10 të burgosur shqiptarë në qendrën e paraburgimit në Mitrovicë. Si rrjedhojë, katër pjesëtarë të stafit të Shërbimit Korrektues me prejardhje etnike shqiptare janë transferuar po ashtu në qendrën e paraburgimit në Mitrovicë, duke shënuar një hap të rëndësishëm në drejtim të krijimit të një qendre paraburgimi shumetnike në Mitrovicë. Nga ana tjetër, hapja e qendrës së paraburgimit në Prishtinë, e planifikuar të fillojë punën nga gushti, ende është në pritje për shkak të mungesës së mensës. Derisa fillimisht qëllimi ishte të mbyllet qendra e paraburgimit në Lipjan dhe stafi e pajisjet e saj të shfrytëzohen në qendrën e paraburgimit në Prishtinë, plani për të mbyllur qendrën e paraburgimit në Lipjan në ndërkohë ka ndryshuar, dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës është duke kërkuar zgjidhje të reja.

EULEX-i, në bashkërendim me disa Organizata Vendore Joqeveritare (OJQ), si dhe me institucione vendore dhe me organizata ndërkombëtare (duke përfshirë Rrjetin e Grave të Kosovës, Zyrën për barazi gjinore, UN Women dhe Programin e Departamentit të Drejtësisë të SHBA-ve për ndihmë në trajnimin për hetime penale ndërkombëtare, kanë kontribuar në organizimin e ‘Asociacionit të Grave në Shërbimin Korrektues të Kosovës’. Synimi i këtij Asociacioni të ri të brendshëm është të avancojnë pozitën e gruas brenda Shërbimit Korrektes të Kosovës, të ngritë vetëdijen për barazinë gjinore dhe të promovojë atë, si dhe të ofrojë mundësi për zhvillimin profesional të femrave. Aktualisht, gratë përbëjnë 13 për qind të stafit të Shërbimit Korrektues të Kosovës, dhe vetëm disa prej tyre mbajnë poste vendimmarrëse. Në pajtim me Ligjin për barazi gjinore, të gjitha institucionet publike në Kosovë janë të obliguara të promovojnë barazinë gjinore dhe të sigurojnë përfaqësim të barabartë gjinor.

Nuk ka pasur përparim të dukshëm lidhur me implementimin e Protokollit teknik të përkrahur nga BE-ja për menaxhimin e integruar të kufirit. Të gjitha takimet për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK) u anuluan nga Beogradi në mars deri në një njoftim të ardhshëm. Krijimi i vendkalimeve të

përhershme të përbashkëta ka vazhduar me ndërtimin e vazhdueshëm të dy nga gjashtë vendkalimeve të përbashkëta, përkatësisht në Merdarë dhe Mutivodë. Puna në hartimin e strategjisë së re / planit të veprimit 2018-2023 për integrimin e menaxhuar të kufirit është duke përparuar. Ka pasur po ashtu disa përparime në implementimin e planit zhvillimor lidhur me Qendrën Nacionale për Menaxhim të Kufirit për vitet 2014-2018, pas miratimit zyrtar të ‘Rishikimit të Qendrës Nacionale për Menaxhim të Kufirit’ dhe Planit të ndërlidhur të veprimit nga ministri i Punëve të Brendshme dhe nga bordi ekzekutiv për menaxhimin e integruar të kufirit.

EULEX-i vazhdon të monitorojë, të këshillojë dhe të informojë mbi implementimin e marrëveshjeve për lirinë e lëvizjes. Misioni ka realizuar disa vizita në terren në të gjitha zyrat e regjistrimit civil dhe në ato të gjendjes civile në katër komunat veriore. Derisa zyrat e regjistrimit civil për lëshimin e dokumenteve, dokumenteve të identifikimit, pasaportave, lejeve të vozitjes dhe regjistrimin e automjeteve janë të gjitha operationale, ku të integruar dhe të punësuar janë zyrtarët e ish-Ministrit të Punëve të Brendshme të Serbisë, zyrat e gjendjes civile janë operationale vetëm në rajonet me shumicë shqiptare, dhe integrimi tani i 37 ish-zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë në këto zyra akoma nuk është përfunduar, përkundër marrëveshjeve të arritura buxhetore. EULEX-i i ka ndarë të gjeturat me autoritetet vendore, me Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Në këto të gjetura EULEX-i ka theksuar rëndësinë e veçantë të krijimit të zyrave të gjendjes civile dhe të infrastrukturës administrative për ofrimin e shërbimeve përkatëse, si dhe njohjen e dokumenteve të lindjes, martesës, vdekjes dhe regjistrimin e automjeteve që u lëshuan nga strukturat e sponsorizuara prej Beogradit.

Sa i përket gjykatës së posaintegruar themelore në Mitrovicë, integrimi vazhdon ecurinë sipas marrëveshjes. Barrierat gjuhësore akoma janë pengesë e madhe duke ndikuar në caktimin e lëndëve. Është arritur përparim në punësimin e përkthyesve shtesë në gjykatë, dhe kryetari i gjykatës themelore në Mitrovicë u ka caktuar gjyqtarëve më shumë se 1000 lëndë (nga periudha 2001 deri më 2008) dhe 500 lëndë (nga nëntori 2017).

EULEX-i ka ofruar monitorim, këshillim dhe informim lidhur me hetimin e vrasjes së politikanit të shquar serb të Kosovës Olliver Ivanović, duke mundësuar takimet në mes të Policisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë për rritjen e shkëmbimit të informacioneve dhe bashkëpunimit për hetimin.

## **2.2. Aktivitetet**



Për shkak të skadimit të mandatit të mëparshëm dhe shuarjes së kompetencave gjyqësore ekzekutive të Misionit, gjyqtarët e EULEX-it ose i përfunduan ose ua dorëzuan të gjitha lëndët e mbetura gjyqtarëve vendorë para 14 qershorit. Ky Mision shënoi përparim në transferimin e dosjeve të lëndëve të prokurorisë dhe policisë institucioneve të Kosovës. Ky dorëzim është duke shkuar mbarë dhe pritjet të përfundohet deri më 14 dhjetor 2018.

Në pajtim me mandatin e tij të ri, Misioni vazhdon t'i ofrojë përkrahje Policisë së Kosovës në bashkëpunimin policor ndërkombëtar. Në këtë drejtim, EULEX-i ka mundësuar shkëmbimin e informacioneve në mes të byrove qendrore nacionale të INTERPOL-it dhe Njësisë koordinuese të Policisë së Kosovës për zbatimin e të drejtës ndërkombëtare, nën ombrellën e Zyrës ndërlidhëse të INTERPOL-it në UNMIK. Përveç kësaj, Misioni i ka dhënë rekomandime Policisë së Kosovës në mënyrë që të ndihmojë zyrtarët e Policisë së Kosovës, të cilët janë duke specializuar në fushën e tregtimit të paligjshëm të veprave të artit. Lidhur me këtë temë është bërë edhe një vizitë studimore në Romë. Misioni po ashtu ka vazhduar shkëmbimin e të dhënave me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë. Mirëpo, shkëmbimi i të dhënave lidhur me rastin e Olliver Ivanoviqit mbetet sfidues.

Ekspertët e mjekësisë ligjore të EULEX-it akoma janë në pritje të një ftese zyrtare nga Ministria e Drejtësisë, për të vazhduar asistimin e autoriteteve vendore në trajtimin e rasteve të personave të zhdukur pas fillimit të mandatit të ri të EULEX-it. Në fund të korrikut, Ministria e Drejtësisë papritmas tërhoqi konfirmimin e ripërtëritjes së kontratës për kompaninë vendore që ofronte ndihmë teknike në vlerësimin e terrenit me ekspertët e mjekësisë ligjore të EULEX-it, me një vendim për të rishpallur tenderin. Derisa procesi i përzgjedhjes është akoma duke vazhduar, kjo ka rezultuar me ndërprerjen e të gjitha punëve në terren që nga fillimi i gushtit. Në fund të gushtit, Qeveria caktoi ushtruesin e detyrës së drejtorit në pozitën e drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore, pas një procesi të gjatë të rekrutimit për shkak të mosinteresimit nga kandidatët e kualifikuar.

Njësia e specializuar e Policisë së EULEX-it vazhdon t'i ushtrojë kapacitetet si reagues i dytë i sigurisë. Për të siguruar gatishmëri operationale të Njesisë së specializuar të policisë janë mbajtur trajnime të brendshme, si dhe trajnime të përbashkëta me Policinë e Kosovës dhe KFOR-in.

### **3. Çështje të tjera kryesore**

Asgjë e rëndësishme për t'u raportuar.

## **Shtojca II**

### **Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar**

Gjatë periudhës raportuese, Dhomat e Specializuara kanë bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të përfundimit të Kodit të sjelljes profesionale për avokatë dhe rregulloreve për ndihmë juridike, me qëllim të menaxhimit të ndihmës ligjore ofruar të akuzuarve dhe viktimave. Dhomat e Specializuara gjithashtu vazhduan monitorimin e krijimit të një trupi përfaqësues të pavarur për të gjithë avokatët e pranuar të punojnë në Dhomat e Specializuara. Avokatët në listat e avokatëve të specializuar mbrojtës dhe avokatëve të viktimave kanë themeluar një grup punues me qëllim të përkufizimit të konturave të trupit përfaqësues të pavarur.

Dhomat e Specializuara vazhduan të bëjnë hapa të mëtejshëm në sigurimin e transparencës dhe qasjes në informacione lidhur me procedurat e ardhshme, përmes krijimit të një baze të besueshme të të dhënave në faqen e tyre të internetit për qasje publike në të dhënat publike të gjykatës, që do të mundësojë kërkime në të tri gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara (shqip, anglisht dhe serbisht).

Dhomat e Specializuara vazhduan me promovimin e aktiviteteve të tyre në terren në Kosovë dhe në Serbi, në ofrimin e më shumë njohurive për mandatin dhe për procedurat e tyre në mesin e shoqërisë civile, dhe në intensifikimin e komunikimeve të drejtpërdrejta me komunitetet e prekura. Nga 16 deri më 19 korrik, shefi i Zyrës së pjesëmarrjes së viktimave në Dhomat e Specializuara u takua me OJQ dhe me organizata të shoqërisë civile në Kosovë, duke mbajtur seanca informuese me komunitetet e viktimave potenciale. Ndërmjet 3 dhe 8 shtator 2018, përfaqësuesit e Dhomave të Specializuara udhëtuan në qytete të ndryshme të Kosovës për t'u angazhuar në aktivitetet në terren, duke përfshirë edhe një tryezë të rumbullakët me rininë, një takim me partnerë vendorë për të planifikuar aktivitetet e ardhshme në terren dhe për të siguruar seanca informuese komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas mbi procedurën e pjesëmarrjes së viktimave në procedurat pranë Dhomave të Specializuara. Nga 17 deri më 19 shtator 2018, përfaqësuesit e Dhomave të Specializuara u takuan me disa shoqata të viktimave dhe mbajtën takime konsultative me organizata partnere të OJQ-ve në Beograd, për të planifikuar strategjinë e ardhshme në terren të Dhomave të Specializuara në Serbi. Përfaqësuesit u takuan gjithashtu me kryetarin e Shoqatës së Avokatëve të Serbisë me qëllim të përgatitjes së një seance informuese për avokatët serbë mbi procesin e aplikimit për t'u pranuar në listat e avokatëve që do të punojnë pranë Dhomave të Specializuara.

Gjatë periudhës raportuese, mbrojtësit e shquar ndërkombëtarë të çështjeve gjinore kërkuan që Administruesja e Dhomave të Specializuara t'i bashkohet rrjetit të lidërshiptit. Administruesja është zotuar të avancojë tutje përfshirjen gjinore në Dhomat e Specializuara dhe të mbajë një takim në terren për të marrë rekomandime mbi integrimin e çështjeve gjinore në ofrimin e shërbimeve mbështetëse gjyqësore.

Ombudspersoni i Dhomave të Specializuara, gjyqtari Pietro Spera, po e prezenton gjithnjë e më shumë zyrën e tij me publikimin e detajeve të plota të rolit dhe funksioneve të Ombudspersonit në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara. Për të avancuar më tej mandatin e tij, më 12 shtator 2018, Ombudspersoni miratoi Kodin e mirësjelljes profesionale për Ombudspersonin, si dhe procedurën e ankesave për personat që pretendojnë shkeljen e të drejtave të njeriut si pasojë e bashkëveprimeve të tyre me Dhomat e Specializuara dhe me Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Si pjesë e strategjisë së tij në terren, Ombudspersoni e bëri vizitën e tij të parë zyrtare në Kosovë nga 3 deri më 5 tetor, duke mbajtur takim njoftues me Avokatin e Popullit të Kosovës dhe duke u dhënë intervista mediave.

Gjyqtarët e Dhomave të Specializuara mbajtën një punëtori treditore të drejtuar bashkërisht me Institutin Nacional për Gjyqësorin e Bullgarisë, prej 26 deri më 28 shtator në Varnë (Bullgari), duke u përqendruar në menaxhimin efikas të procedurave, në vendimet e përkohshme dhe në përpilimin e aktgjykimeve.

Në shtator të vitit 2018, kryetarja e Dhomave të Specializuara u takua me komandantin e ri të operacioneve civile dhe drejtorin e Mekanizimit për planifikim civil dhe mirësjellje të Shërbimit Evropian për Punë të Jashtme në Bruksel me qëllim të dhënies së informacioneve të përditësuara mbi zhvillimet e fundit në Dhomat e Specializuara. Ajo po ashtu u takua me ambasadorë të disa shteteve anëtare të BE-së.

Ndërveprimi i Dhomave të Specializuara me shtetin nikoqir dhe me partnerët tjerë të jashtëm vazhdon në lidhje me renovimin dhe kalimin në hapësirat e reja të Dhomave të Specializuara në Hagë. Administruesja ka kontakte dhe takime të rregullta me ambasadorin për organizata ndërkombëtare të Mbretërisë së Holandës, dhe me Ministrinë e Drejtësisë dhe Sigurisë së Holandës, për të siguruar që shërbimet që duhet të ofrohen nga shteti nikoqir të jenë në dispozicion të Dhomave të Specializuara.

Jack Smith, një prokuror i SHBA-së me përvojë në hetime ndërkombëtare penale, e morri postin e Prokurorit të Specializuar më 11 shtator. Ai zëvendësoi David Schwendiman, Prokurorin e parë të Specializuar dhe ish-Kryeprokurorin e grupit veprues special hetimor, i cili u tërhoq në fund të marsit, kur skadoi mandati i tij si zyrtar i lartë për punë të jashtme në Departamentin e Shtetit të SHBA-së. Në periudhën e ndërmjetme, zëvendësprokurori special, Kwai Hong Ip, e drejtoi Zyrën e Prokurorit të Specializuar, duke zbatuar hetimin për pretendimet e përfshira në raportin e janarit 2011 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të titulluar “Trajtim johuman i njerëzve dhe trafikim i paligjshëm i organeve njerëzore”, duke siguruar kështu vazhdimësinë e punës.

Sipas Ligjit për themelimin e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar, Dhomat e Specializuara kanë parësi mbi të gjitha gjykatat e tjera në Kosovë. Prokurori i Specializuar, në mes të tjerash, ka autoritetin t’u kërkoj institucioneve të Kosovës ndihmesë. Përveç kësaj, EULEX-i, sipas mandatit të tij të ri, ofron mbështetje logjistike dhe operacionale për Dhomat e Specializuara dhe për Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Me avancimin e hetimeve, ndihma e tillë, si dhe ajo nga autoritetet e Beogradit, nga Bashkimi Evropian dhe nga komuniteti i gjerë ndërkombëtar, do të bëhet gjithnjë e më e rëndësishme. Zyra e Prokurorit të Specializuar kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe përkrahje të plotë të bashkësisë ndërkombëtare, të organizatave ndërkombëtare dhe të shteteve individuale në të gjitha aktivitetet e saj.

### Shtojca III

#### Përbërja dhe kapaciteti i komponentës së policisë të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

(nga 1 tetori 2018)

<i>Shteti</i>		<i>Femra</i>	<i>Meshkuj</i>	<i>Gjithsej</i>
Austria		1		1
Bullgaria			1	1
Finlanda			1	1
Gjermania		1		1
Hungaria			2	2
Federata	Ruse	1	2	3
Turqia			2	2
<b>Gjithsej</b>		<b>3</b>	<b>8</b>	<b>11</b>

#### Përbërja dhe kapaciteti i komponentës ndërlidhëse ushtarake të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

(nga 1 tetori 2018)

<i>Shteti</i>		<i>Femra</i>	<i>Meshkuj</i>	<i>Gjithsej</i>
Republika	Çeke	1	1	2
Moldavia			1	1
Polonia			1	1
Rumania			1	1
Turqia			1	1
Ukraina			2	2
<b>Gjithsej</b>		<b>1</b>	<b>7</b>	<b>8</b>



Map No. 4133 Rev. 77 UNITED NATIONS  
September 2018 (Colour)  
Field Support Group of  
Information Section  
Homeby Cartographic  
Section